



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 872/13 prot.

Tiranë më 14.7.2022

REKOMANDIM

Nr. 02, datë 14.7.2022

PËR KONTROLLUESIN “NOTER AGRON BAJRI”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Noter Agron Bajri” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 69, datë 06.05.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasi , në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Hetimi administrativ pranë Kontrolluesit u fokusua në trajtimin e ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit të z. , administruar me nr. 872 Prot., datë 26.04.2022, nëpërmjet të cilës pretendon se, është njoftuar me një mesazh në platformën e-Albania, në llogarinë e tij dhe në llogarinë e bashkëshortes së tij, znj. , se noteri Agron Bajri i Dhomës Kombëtare të Noterëve ka gjeneruar respektivisht, dokumentin “Çertifikatë familjare” dhe dokumentin “Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin”, pa dijeninë e tyre.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi me Nipt: K72106013Q, është person fizik i licencuar nga Ministri i Drejtësisë për kryerjen e veprimtarisë noteriale sipas ligjit Nr. 110/2018 “për Noterinë”.

Në kuadër të trajtimit të ankesës, grupi i hetimit administrativ konstatoi se më datë 14.04.2022, me kërkesë individuale paraqitur verbalisht nga një person i vetëidentifikuar si ankuesi z. _____, Kontrolluesi (asistentja e zyrës) ka hyrë në sistemin e-Albania duke pasur akses për aktet *Certifikatë familjare për z. _____ dhe dokumentin Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin znj. _____*.

Gjithashtu, grupi i hetimit administrativ ka konstatuar se aksesimi i të dhënave është bërë nga punonjësja e Kontrolluesit, bazuar vetëm në një fotografi të kartës ID, të z. _____, të cilën e ka patur në telefon personi i paraqitur në zyrën e Kontrolluesit, dhe nga ana e punonjësit nuk është marrë paraprakisht deklarata e pëlqimit sipas parashikimit të pikës 24, të nenit 3 të Ligjit.

2. Nga verifikimi i kryer rezultoi se, nuk provohet që Kontrolluesi të ketë kryer përhapje të të dhënave personale të z. _____ dhe znj. _____, drejt subjekteve të tjera të të dhënave, si dhe nuk provohet që këto të dhëna të jenë përdorur për ndonjë qëllim të caktuar.
3. Gjithashtu, Kontrolluesi në datën 16.04.2022, nëpërmjet avokatit të tij, i është drejtuar “*Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative, BIRN Albania*”, në vëmendje “ _____”, ku ndër të tjera, e informon se në datën 14.04.2022, në zyrën e tij është paraqitur një person me kartën ID të subjektit të të dhënave (ankuesi).

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit. Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, palët janë ftuar të marrin pjesë në seancë dëgjimore, në datën 13.06.2022, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, janë paraqitur përfaqësuesit e Kontrolluesit, si dhe ankuesi.

Në seancën dëgjimore u paraqit dhe punonjësja e Kontrolluesit, duke shpjeguar tërësinë e veprimeve të kryera prej saj.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit në seancën dëgjimore deklaruan pretendimet e tyre dhe i depozituan ato me shkrim, ku evidentuan edhe masat e marra në drejtim të faktit se veprimi lidhej me një kërkesë të paraqitur, si dhe me faktin se ky veprim është bërë pa asnjë lloj tendence, por thjesht mbi një kërkesë individuale, dhe është ndërprerë sapo nuk është nënshkruar deklarata për dhënien e pëlqimit.

Nga ana tjetër, shpjeguan dhe masat e marra në drejtim të sqarimit të situatës së ndodhur dhe rikuperimin e pasojave të ardhurave.

Pretendimet e Kontrolluesit:

- ✓ Në zyrën e punës para punonjësës , është paraqitur një person i identifikuar me emrin , i cili ka paraqitur si mjet identifikimi përmes telefonit të tij, kartën e identitetit (ID). Me vullnetin e mbajtësit të të dhënave asistent-noteri ka bërë fotografimin e dokumentit dhe kërkimin përkatës mbi këto të dhëna, duke shpjeguar se duhej nënshkrim për dhënien e pëlqimit dhe duke marrë dakordësinë se nënshkrimi do jepej. Këto veprime nuk janë finalizuar, pasi qytetari nuk ka nënshkruar deklaratën përkatëse dhe nuk ka sjellë akt identifikues origjinal. Veprimet pa asnjë lloj tendence janë kryer nga asistentja e zyrës e cila s'ka asnjë lidhje me detyrën e gazetarit.
- ✓ Ankuesi dhe redaksia në të cilën ai punon është lajmëruar vullnetarisht nga ana jonë.
- ✓ Të dhënat e z. nuk janë shkarkuar, printuar apo shpërndarë nga serveri i zyrës së noterit, dhe janë eliminuar/fshirë nga rubrika e kërkimit të sistemit noterial, që në momentin kur ka ndodhur fakti mbi të cilin z. , u vendos prej nesh në dijeni.
- ✓ Kërkoj të sjell në vëmendjen tuaj se, gjenerimi i të dhënave për individë të ndryshëm, bëhet mbi bazën e kërkesave të tyre verbale pranë zyrave që kanë akses në këto të dhëna. Deri aktualisht, në praktikë ndodh rëndom të kërkohen të dhëna të tilla. Ndaj dhe pas këtij episodi normalisht që nga ana jonë, u është dhënë porosi specifike punonjësve të zyrës të kenë një vëmendje të shtuar në raport me çdo kërkesë që bëhet. Për këtë arsye, është hartuar dhe rregullore “Për vendosjen e rregullave dhe kushteve specifike për punonjësit e zyrës së Noterisë”, e datës 01.06.2022 “Mbi funksionimin e zyrës së Noterisë”.

Pretendimet e Ankuesit:

- ✓ Ankuesi tregon se nëpërmjet portalit e-albania është njoftuar se akte personale të tij dhe bashkëshortes së tij, janë gjeneruar nga Noteri Agron Bajri.
- ✓ Ankuesi tregon se as ai dhe as bashkëshortja nuk kanë dhënë pëlqimin tek ky Noter për kryerjen e asnjë veprimi.
- ✓ Gjithashtu ankuesi tregon se ka dyshime që ky veprim është kryer nga Noteri për shkak të punës së tij si gazetar.

Në përfundim, referuar dokumentacionit dhe provave të tjera të administruara gjatë hetimit administrativ dhe pasi dëgjoi pretendimet e palëve gjatë seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit vlerëson se:

Pavarësisht dinamikës së ngjarjes së ndodhur, veprimeve të kryera nga punonjësja e zyrës së Kontrolluesit, paraqitjen e një personi duke u prezantuar si ankuesi, si dhe faktin që të dhënat e z. nuk janë shkarkuar, printuar apo shpërndarë nga serveri i zyrës së

noterit, ky shërbim, në rrethanat në të cilat është realizuar, nuk përkon me përmbushje të plotë të legjislacionit në fuqi.

Për vetë rëndësinë që paraqesin të dhënat personale, ruajtja dhe sigurimi i tyre çdo kontrollues duhet të manifestojë jo vetëm kujdes specifik, por një vëmendje të veçantë në aksesimin, përdorimin apo gjenerimin e këtyre të dhënave.

Në këtë kuadër, Udhëzimi i përbashkët i hartuar nga Komisioneri dhe Ministri i Brendshëm, nr. 463, datë 10.12.2020 "*Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin*", përcakton subjektet kontrolluese që kanë akses në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, në regjistrat themeltarë dhe në aktet e Gjendjes Civile. Sipas Aneksit 1, të bashkëlidhur këtij Udhëzimi, këtë akses e kanë edhe subjektet të cilët ushtrojnë veprimtari "*Noteri*". Sidoqoftë ky akses nuk është i pakufizuar dhe lidhet me funksionet e secilit kontrollues.

Sa më sipër, Kontrolluesi nëpërmjet sistemit, e-Albania ka akses në Regjistrin e sipërcituar dhe ofron shërbime të ndryshme për klientët nëpërmjet aksesit të të dhënave personale të këtij Regjistri.

Megjithatë, mënyra e aksesimit të dokumentacionit në rastin konkret, me një mungesë kujdesi që konsiston në mosmarrjen paraprake të pëlqimit me shkrim, ka pasqyruar dhe këtë situatë, ku krijohen nga ankuesi dyshime që një aksesim i tillë është bërë për shkak të punës së tij.

Është e detyrueshme që çdo Kontrollues (noter) të veprojë në përputhje me parashikimet e ligjit të posaçëm "*për noterinë*", ligjit "*për mbrojtjen e të dhënave personale*" si dhe akteve nënligjorë në zbatim të tij.

Në germën "*b*", të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit parashikohet se, mbrojtja e të dhënave personale bazohet "*në grumbullimin përpunimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime*".

Në germën "*ç*", të pikës 1, të nenit 6 të Ligjit parashikohet si kriter ligjor i përpunimit, të dhënat personale përpunohen vetëm "*për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit*".

Në referim të dispozitave të sipërcituara, kontrolluesit që ushtrojnë veprimtarinë në zbatim të ligjit "*për noterinë*" duhet të mos tejkalojnë qëllimin e përpunimit, sipas parashikimeve në ligjin e tyre të posaçëm.

Siç evidentohet nëpërmjet provave si dhe e pranuar nga Kontrolluesi, grupi i hetimit administrativ ka konstatuar se aksesimi i të dhënave është bazuar në një kërkesë individuale, është paraqitur si mjet identifikimi, një kartë ID, të z. _____, të cilën e ka patur në telefon personi i paraqitur në zyrën e Kontrolluesit. Mungesa e kujdesit

duket tek mosmarrja e deklaratës së pëlqimit paraprakisht, si një kriter ligjor që duhet zbatuar sipas parashikimit të pikës 24, të nenit 3 si dhe nenit 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit. Në këtë rast, ekzistenca e pëlqimit është e vetmja mundësi ligjore e Kontrolluesit për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale të ankuesit, ndaj dhe pëlqimi duhet të jepet që në fillim.

Në këtë kuadër, aksesimi i të dhënave për individë të ndryshëm, mbi bazën e kërkesave të tyre verbale, pranë zyrave që kanë akses në këto të dhëna siç është realizuar nga Kontrolluesi (pavarësisht ose jo personalisht prej tij), në rastin konkret, është kryer në kushtet e mosdhënies se pëlqimit me shkrim paraprak.

Në të gjitha rastet, pëlqimi duhet të jetë specifik, me shkrim, i shprehur qartë dhe i dhënë me vullnetin e lirë të subjektit të të dhënave personale kundrejt informimit paraprak dhe gjithëpërfshirës, lidhur me proceset dhe afatet e përpunimit të të dhënave të tij personale, në përputhje me nenin 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson gjithashtu se, Kontrolluesi ka lejuar aksesin në të dhënat përkatëse të punonjësit të Zyrës, por nuk ka treguar vëmendjen e duhur që punonjësi ta kryejë atë siç duhet, me qëllim parandalimin e rreziqeve të tilla si akses i paautorizuar në të dhënat personale sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi. Është detyrim i Kontrolluesit që të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale si dhe aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, si dhe nga çdo formë tjetër përpunimi.

Kontrolluesi duhet të marrë masat e duhura që çdo punonjës zyre, i cili ka akses të lejuar në rolin ndihmës sipas parashikimeve të ligjit “për noterinë”, të kryejë detyrat e tij në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues, të natyrës së veprimtarisë që ushtron, si dhe për shkak të kategorive të të dhënave personale që përpunon, kërkohej masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale. Hyrja në të dhënat dhe programet që disponon Kontrolluesi duhet të bëhet vetëm nga personat e autorizuar dhe në bazë të verifikimit paraprak në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit.

Kontrolluesi, duhet të merrte masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Është detyrim i kontrolluesit të trajnojë dhe udhëzojë punonjësit, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë Ligj, si dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe Rregulloret “për sigurinë e të dhënave”.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 27, 29, 30, 31 pika 1, germa “a/I”, si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të germës “b”, të nenit 5 të Ligjit, të ketë në vëmendje dhe të marrë masa në mënyrë që çdo veprim i kryer nga zyra e tij, të realizohet vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë e legjitime dhe në aksesimin në përputhje me këto qëllime;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për aksesimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 6 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, në vazhdimësi të ketë në vëmendje parashikimin e pikës 24, të nenit 3 të Ligjit, mbi marrjen e pëlqimit paraprak dhe ta sigurojë atë para se të fillojë aksesimi në të dhënat personale të subjekteve;
4. Kontrolluesi në zbatim të nenit 27 të Ligjit të marrë masa teknike dhe organizative të përshatshme në lidhje me sigurinë e të dhënave personale dhe të marrë masa konkrete për trajnimin e punonjësve;
5. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 14.7.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

